


**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NE PEJË**, duke vendosur ne procedurë kundërvajtëse kundër të pandehurit Elez Hajdari nga fsh.Shushicë, K-Istog, për kundërvajtje nga neni 6 par.1 të Ligjit nr.03/L-151, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të nenëve 30, 74, 123, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt.26.06.2012, bie këtë:

### A K T V E N D I M

		REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep	DPK / DMP	Nr. Prot	
Dep		Pr. Prot	03-2947/12
Obj		Prot No	
Nr. i treg.		Data	
Obj. Komunale	03	Datum	22-08-2012
Nr. i regj.		Data	

**I PANDEHURI: Elez (Ramë) Hajdari**, i lindur me datë 25.07.1957, nga fsh.Shushicë, K-Istog, me banim në Istog, Rr.Rinisë, nr.24, me profesion Ing.i Makinerisë, anëtarë i Bordit të Drejtorëve pranë KUR-“Hidrodrini” Sh.A, në Pejë, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin e makinerisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i R.së Kosovës, më parë i pa dënuar;

### ËSHTË PËRGJEGJËS

Ngase në cilësi të zyrtarit të lartë publik, Anëtarë i Bordit të Drejtorëve pranë KUR-“Hidrodrini” Sh.A, në Pejë, nuk e ka përmbushur obligimin e tij ligjor, për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2011, në afatin e përcaktuar me ligj deri me 31 mars 2011.

-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par.1 të Ligjit nr.03/L-151, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore, e në vështrim të nenit 16 par. 1 pika 1.1 të Ligjit nr.03/L-151, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

### D E N O H E T

**ME DËNIM NË TË HOLLA në shumë prej 300.(treqind) €**, të cilin është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të shndërrimit në dënim burgu duke llogaritur 15€ për një ditë.

Obligohet i pandehuri që në emer të shpenzimeve gjyqësore të paguaj gjykatës shumë prej **5 €**, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimin.

### A r s y e t i m

**Agjencia Kundër Korrupsionit, Dep.i Parandalimit, Prishtinë**, me kërkesën Nr.01-3193-11 të dt.14.07.2011, ka kërkuar nga Gjykata zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Elez Hajdari, anëtarë i Bordit të Drejtorëve pranë KUR “Hidrodrini” Sh.A. në Pejë, për kundërvajtje nga neni 6 par.1 të Ligjit nr.03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

I pandehuri ne mbrojtjen e tij, ka deklaruar se qe me 31.01.2012 emëruar anëtarë i Bordit te Drejtorëve pranë KUR "Hidro Drini" Sh.A. në Pejë, dhe me dt. 31.01.2012 është shkarkuar nga detyra për shkak të konfliktit të interesit meqenëse në kuadër të kompanisë ku është anëtar i Bordit edhe punon në punë dhe detyra të punës përgjegjës për furnizim me ujë në Njësinë Operative Istog. Sa i përket deklarimit të pasurisë për vitin 2011, ka njoftuar gjykatën se në muajin shtatorë të vitit 2011 për mes Kryetarit të Bordit të Kompanisë Z. Shkelzen Hyseni, është njoftuar se lidhur me të ka ardhur një vërejtje nga ana e Agjencionit Kosovare kundër Korrupsionit për mos deklarim të pasurisë, dhe se ky është i vetmi njoftim që ka marrë përmes Kryetarit të Bordit për deklarim të pasurisë, ndërsa me herët nuk ka pas ndonjë njoftim tjetër për obligim të deklarimit të pasurisë, ashtu që me të marrë njoftimin ka pregaditur formularët edhe të njëjtat i ka dorëzuar Agjencionit me dt. 28.10.2011, për çka gjykatës i prezantoi në shikim edhe vërtetimin me nr.03-4193/11 të dt. 28.10.2011, duke kërkuar nga gjykata që me rastin vendosjes ta ketë parasysh deklaratën e tij.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata në cilësi të dëshmitarit e ka dëgjuar Ferasete Alija, e cila ka deklaruar se pranë Kompanisë KRU "Hidrodrini" Sh.A. në Pejë, është e caktuar me detyrat e punës si kryesuese e Departamentit Juridik pranë Kompanisë, dhe në kohën e kundërvajtjes sipas kërkesës, ka punuar si sekretare e Bordit të drejtorëve të kompanisë. Ka njoftuar gjykatën se nga ana e agjencionit kundër korrupsionit ka marrë shkresën për deklarimin e rregullt të pasurisë të zyrtarëve të lartë para skadimit të afatit 31.03.2011, ashtu që pas marrjes së kërkesës, agjencionit i ka dorëzuar listën e zyrtarëve të lartë të obliguar për deklarim të pasurisë, ndër të cilët është edhe këtu i paraqituri Elez Hajdari si anëtar i bordit, dhe gjithë anëtarëve të bordit ju ka dorëzuar edhe formularët të agjencionit për deklarim të pasurisë, të cilët kanë qenë të obliguar ti plotësojnë dhe t'ia dorëzojnë agjencionit deri me dt.31.03.2011, plotësimi dhe dorëzimi i formularëve të agjencionit kundër korrozionit është obligim i tyre ligjor dhe se nuk ka njohuri si kanë vepruar ata pas marrjes së formularëve për deklarim.

Gjykata nga mbrojtja e të pandehurit, deklarata e dëshmitarës dhe pas vlerësimit të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse si dhe shkresave tjera të lëndës, e duke pasur parasysh obligimin e zyrtarit të lartë për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë në pajtim me nenin 6 par.1 të Ligjit nr.03/L-151, ka gjetur se i pandehuri është përgjegjës për kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, e për të cilën e shpalli përgjegjës dhe e denoi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Mbrojtjes së të pandehurit gjykata nuk ia falë besimin me që i njëjti kishte për qëllim shmangien nga përgjegjësia kundërvajtëse.


Gjatë matjes së dënimit u muarrën parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, megjithatë gjykata ka bindjen se me dënimin e shqiptuar në masë të mjaftueshme do të ndikoj pozitivisht në ndërgjegjësimin e tij në të ardhmen që të mos përsërisë kundërvajtje të tillë.

Vendimi mbi pagesën e shpenzimeve gjyqësore, u muar në kuptim të nenit 109 par.1 pika 6 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Andaj nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**NGA GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PEJË,**

Regj.Nr.5-10339/11, me dt.26.06.2012



03-2947/12/03  
sluaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Këtij aktvendimi mund të bëhet ankesë,  
Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë,  
në afatin prej 8 ditëve nga dita e dorëzimit të  
këtij aktvendimi në përmes të kësaj Gjykate.